

*EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri*

1 nëntor 2011, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në Mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit sot ka mbajtur konferencë për shtyp në lidhje me projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Në konferencë edhe një herë u potencua se shoqëria civile dhe qytetarët e Prizrenit nga viti 2009 janë duke i artikuluar pakënaqësitë e tyre në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit eventual të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të sponsoruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe aktualisht në procedurë të shqyrtimit parlamentar.

Fillimisht u prezantuan përpjekjet e deritanishme për të kundërshtuar këtë projekt-ligj, duke filluar nga viti 2009 kur nisi hartimi i projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Reagimi fillestar i shoqërisë civile të Prizrenit ishte në raport me procesin e mbyllur të hartimit të projekt-ligjit, ndërsa gjatë vitit 2010 dhe 2011 OJQ-të kanë tentuar aktivisht që të hapin këtë proces. Me letra të hapura, OJQ-të e Prizrenit iu kanë drejtuar komunës së Prizrenit, Kuvendit të Kosovës dhe qeverisë qendrore. Paralelisht janë publikuar shumë deklarata dhe shkrime për të shfaqur pakënaqësitë e qytetarëve të Prizrenit dhe për të aeluar për ndërprerjen e praktikave jodemokratike. Para rreth dy muajsh, Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve ka sponsoruar edhe një Peticion të qytetarëve të Prizrenit, me mbi 10.000 nënshkrime për të kundërshtuar projekt-ligjin.

Në vijim janë ofruar argumentet për shkelje të Kushtetutës së Kosovës, Planit të Ahtisaarit, ligjeve të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor. Në aneksin e pestë të Pakos së Ahtisaarit, i cili flet për “trashëgiminë fetare dhe kulturore”, në nenin 4 mbi “zonat e mbrojtura”, paragrafi 4.1.7. e obligon komunën e Prizrenit që të themelojë zonën e veçantë për Qendrën Historike të Prizrenit. Përpjekja e qeverisë së Kosovës që përmes një ligji qendror dhe duke e përjashtuar komunën e Prizrenit të themelojë Qendrën Historike është në kundërtim me Planin e Ahtisaarit. Për më tepër, ky projekt-ligj shkel kushtetutën e Kosovës në tri pika të ndieshme: laiciteti, neutraliteti i çështjeve fetare dhe diskriminimi. Neni 8 i Kushtetutës e definon Kosovën shtet laik. Komiteti për Trashëgimi Kulturorore, që parashihet me këtë projekt-ligj, do të ketë tre anëtarë nga bashkësitë fetare, duke i kamufluar ata si përfaqësues të shoqërisë civile. I njejti nen i Kushtetutës e definon Kosovën si neutral në çështjet e besimeve fetare. Përmes Komitetit për Trashëgimi Kulturorore, bashkësitë fetare do të inkuadrohen në ushtrimin e pushtetit publik. Ndërsa, në këtë Komitet do të jenë të përfaqësuar vetëm tri bashkësi fetare, derisa në Prizren ekzistojnë edhe komunitete tjera fetare, me ç'rast mospërfshirja e tyre paraqet diskriminim, dhe shkelje e parimeve kushtetuese të mosdiskriminimit.

Përveç këtyre shkeljeve, gjatë konferencës u prezantuan edhe argumentet për dyfishime ligjore dhe institucionale të do të sjellë projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Shumë elemente që i propozon projekt-ligji tashmë janë pjesë integrale e sistemit kushtetues dhe institucional të Kosovës. Konkretisht, neni 9 i Kushtetutës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare, neni 58 garanton ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës, si dhe mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet. Për më tepër, e drejta e pronës (neni 46) dhe liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 38) janë kategori të drejtash që garantojnë me Kushtetutën e Kosovës. Përveç garancive kushtetuese, ekziston edhe një kuadër i gjerë ligjor që siguron mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ligji për Trashëgiminë Kulturorore, Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Integruar të Trashëgimisë Kulturorore (MKRS), Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit (KK Prizren) ofrojnë bazë të qëndrueshme ligjore për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. I gjithë ky

sistem ligjor, sipas OJQ-ve të Prizrenit, dëshmon se nuk kemi nevojë për edhe një ligj tjetër, por fokusi i institucioneve shtetërore duhet të jetë tek zbatimi i ligjeve ekzistuese.

Në një përshkrim kronologjik të ngjarjeve, OJQ-të e Prizrenit kanë treguar se grupi punues për projekt-ligjin, në kuadër të MMPH-së nga viti 2009 ka punuar në fshehtësi të plotë, ndërsa në grupin punues ka ftuar vetëm nga një përfaqësues të institucioneve relevante, duke e lënë shoqërinë civile jashtë procesit. Komuna e Prizrenit ka patur vetëm një përfaqësues në këtë grup punues, ndërsa asnjë herë nuk janë zhvilluar konsultime publike me qytetarët e Prizrenit në pajtim me Rregulloren e Qeverisë. Zyra Civile Ndërkombëtare dhe udhëheqësi i kësaj zyreje Z. Peter Faith, aktivisht dhe publikisht avokojnë për nevojën për një ligj për Qendrën Historike të Prizrenit, duke i nxitur institucionet shtetërore të hartojnë dhe miratojnë sa më parë këtë ligj, edhe pse kjo praktikë është në kundërshtim me Planin e Ahtisaarit. Nën presionin e ICO, MMPH pa zhvilluar konsultime publike për projekt-ligjin, e ka proceduar atë në Kuvendin e Kosovës për miratim. Kuvendi i Kosovës e ka refuzuar projekt-ligjin në lexim të parë dhe e ka kthyer në qeveri, ndërsa kjo e fundit, pas një jave e ka dërguar projekt-ligjin përsëri në Kuvend, pa ndryshuar as edhe një fjalë në përmbajtjen e tij. Në shqyrtimin aktual të projekt-ligjit, Komisioni parlamentar për Planifikim Hapësinor për herë të dytë, dhe përsëri unanimisht ka vendosur për kthimin e projekt-ligjit në qeveri, derisa Komisioni parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Peticione ka artikulluar argumentet për shkelje kushtetuese të këtij projekt-ligji. Dhe derisa projekt-ligji gjendet në shqyrtim parlamentar, MMPH tenton të improvizojë konsultime publike për projekt-ligjin.

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit ka propozuar këta hapa konkretë për dalje nga kjo situatë:

- Të hudhet poshtë projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit,
- Të respektohen dhe të gjejnë zbatim ligjet dhe institucionet ekzistuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,
- Ministri i Kulturës, me kërkesë të komunës së Prizrenit, të shpallë mbrojtjen e përkohëshme të Qendrës Historike të Prizrenit,
- Gjatë periudhës një vjeçare të mbrojtjes së përkohëshme, komuna e Prizrenit, në përputhje me obligimin që del nga Pakoje Ahtisaarit, të iniciojë procesin e themelimit të Qendrës Historike të Prizrenit,
- Në nivel praktik, komuna e Prizrenit të themelojë një grup punues ndërsektoral, në përbërje të cilit do të jenë edhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe institucioneve tjera relevante
- Shoqëria civile e Prizrenit të jetë pjesë përbërëse e këtij grupi punues dhe të ketë numër të konsiderueshëm anëtarësh, për të siguruar përfaqësim të duhur të të gjitha grupeve të komunitetit,
- Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Konservimin e Integruar të Trashëgimisë Kulturore (MKRS) dhe Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit (KK Prizren) të konsiderohen dokumente referencë dhe udhërrëfyes për themelimin e Qendrës Historike të Prizrenit,
- Të organizohen konsultime publike me të gjitha grupet e komunitetit në Prizren, për të përfshirë nevojat dhe sugjerimet e tyre në formalizimin dhe menaxhimin e Qendrës Historike të Prizrenit,
- Komuna e Prizrenit të hartojë Planin e Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit,
- Kuvendi i Komunës së Prizrenit të miratojë një Rregullore komunale, përmes së cilës do të themelohet Qendra Historike e Prizrenit.

Në rast se nuk do të merret parasysh vullneti i qytetarëve të Prizrenit, OJQ-të e Prizrenit kanë paralajmëruar edhe veprime të tjera. Nëse projekt-ligji miratohet në Kuvendin e Kosovës, OJQ-të do ta dërgojnë atë në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa nuk përjashtohet edhe mundësia e protestave qytetare, deri në organizimin e padëgjueshmërisë qytetare në zonën e Qendrës Historike të Prizrenit.

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit

*EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri*